

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
Infolab SHPK**

I. DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Sot më datë 12.12.2018, në Tiranë, në bazë të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", me vullnetin e tij të plotë dhe të lirë, ortaku i shoqërisë:


z. Bledar HITAJ, lindur në Vlorë i datëlindjes 17.05.1980 dhe me banim në Tiranë, shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me letër njoftim me nr. **I00517093L** miraton statutin e shoqërisë si vijon:

Shoqëria Tregtare **Infolab SHPK** rregullon poziten e saj juridike, marrëdhëniet ndërmjet ortakeve, funksionimin dhe kompetencat e organeve të saj, llojin e shoqërisë, kohezgjatjen e veprimtarisë së saj, marrëdhëniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", dhe dispozitat e tjera të legjislativës shqiptare në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e shoqërive tregtare.

**NENI 1
Objekti i veprimtarisë**

1.1 Shoqëria ka si objekt veprimtarite që vijojnë si më poshtë:

Kërkimin, zhvillimin, projektimin, zbatimin, prodhimin, menaxhimin, tregtimin, qiradhënien, dhe përfaqësim të produkteve, sistemeve, programeve dhe shërbimeve që lidhen me sektorin e telekomunikacionit, multimediale dhe informacionit, duke përfshirë edhe përdorimin e rrjeteve, qendra vetëshërbimit dhe aparateve terminale; Kërkimin, zhvillimin, zbatimin, prodhimin dhe tregtimin e programeve elektronike ("software"), në përgjithësi dhe në veçanti përfshirë telefonisë dhe kompjuterike; shërbimet e asistencës, mirëmbajtjes dhe riparimit të programeve (software), makinerive dhe aparateve dhe/ose jo elektronike; zbatimin e sistemeve të informimit dhe të gjitha aktivitetet e lidhura, duke përfshirë shitjen dhe asistencën; projektimin, implementimin si me anë të pajisjeve mekanike (hardware) ashtu edhe me protokollet dhe (software) të aplikuar, mirëmbajtjen e rrjeteve kompjuterike në përgjithësi dhe ato locale në ambient shtëpie dhe zyra (LAN) të përshtatura për t'ulidhur së bashku, në çdo mënyrë të mundësuar nga teknologjia në dispozicion, kompjutera personale, poste pune, qendra shërbimi (Server) dhe sisteme të përpunimit në përgjithësi apo që janë të përshtatura të lidhin këto sisteme me rrjete të tjera si locale ashtu dhe metropolitane, me rreze të gjërë dhe globale (MAN, WAN, INTERNET, etj) si dhe optimizim dhe mirëmbajtje e rrjeteve kompjuterike paraekzistuese; zbatimin, menaxhimin,



mirëmbajtjen, qiradhënien dhe organizimin e stacioneve dhe terminaleve të transmetimit të të dhënave (të quajtur "totem" apo "kulla") për hyrje në INTERNET, për "navigimin" e tij dhe për të gjitha shërbimet e tjera të ofruara në terminale të tilla; krijimin, publikimin dhe menaxhimin për vete dhe për të tretë, të faqeve dhe portaleve në rrjetet kompjuterike ndërkombëtare (aktualisht "INTERNET"), kombëtare dhe lokale, duke përdorur pajisjet/kompjuterat e veta apo të të tjerëve, me ideimin dhe organizimin kompjuterik elektronik të këtyre faqeve, të zhvillimit të portaleve, të hapësirave për reklamat dhe tregtinë elektronike/kompjuterike; realizime, përpunime grafike dhe menaxhim të imazheve publicitare, dizenjime, imazhe dhe simbole komerciale, profesionale, kulturore, artistike dhe sociale në përgjithësi; krijimin, menaxhimin dhe tregtimin e bankave të të dhënave kompjuterike/elektronike dhe të motorëve të kërkimit kompjuterik/elektronik, edhe në rrugë ajrore dhe satelitore, organizim kërkimesh, përzgjedhje, klasifikim dhe përpunim të të dhënave të të gjitha llojeve me anë të instrumenteve elektronike dhe informatike; aktivitet tregtie elektronike; mbledhjen, prodhimin, përpunimin, ruajtjen, shkëmbimin dhe shpërndarjen e informacionit përmbështetjen e aktivitetit profesional, të biznesit dhe të kohës së lirë, zbatimin e studime vetë fizibilitetit, kërkimore, konsultim, projektim dhe menaxhim të projekteve, vlerësimin e përshtatshmërisë teknike dhe ekonomike, studime të ndikimit në mjedis, nëfushën e elektronikës dhe kompjuterike/telematike për zhvillimin e software-ve dhe hardware-ve; Kryerja për vete ose për të tretët e shërbimeve në vijim: organizim, promovim dhe zhvillim kursesh, seminaresh, konferencash, meetings dhe në përgjithësi të çdo mjetit jetër për zhvillimin, shpërndarjen, mësimin dhe promovimin e të gjitha aktiviteteve që lidhen me objektin e veprimtarisë; organizim, trajnim, zhvillim dhe aplikimi sistemeve dhe teknikeve të drejtimit, të "direct marketing", tregtare dhe të korporatave, si dhe analiza dhe planifikime ekonomike, teknike dhe tregtare. Projektimi, zbatimi, menaxhimi i impianteve dhe rrjeteve tetelekomunikacionit, fiks, celular ose satelit, për ushtrimin dhe ofrimin, pa kufij territoriale, të shërbimeve të komunikimeve, ose në lidhje me, komercializimin e produkteve, shërbimeve dhe sistemeve të telekomunikacionit, telematike, multimedia dhe elektronike, të lidhjes dhe/ose interkoneksionit me rrjetet e tjera, dhe shpërndarjen nëpër të njëjtat rrjete, të informacioneve kulturore, teknike, arsimore, reklamave, argetim, ose çdo lloji tjetër, në çdo formë, edhe për llogari të treta. Analiza, projektimi, zhvillimi, dokumentimi, instalimi i sistemeve informatike, telematike edhe në fushën Web dhe zbatimin e rrjeteve lokale dhe shërbimeve të lidhura me to, ndertimin dhe menaxhimin e faqeve të internetit. Ideimin, realizimin, kujdesin, administrimin dhe mirëmbajtjen, si për veten e tyre ose në emër të paleve të treta, të faqeve të internetit, duke përfshirë të gjitha aktivitetet e Web marketing. Komunikacion marketing.

Shërbime "Business to business barter" dhe "Advertising barter". Planifikimi, zbatimi dhe menaxhimi i faqeve të internetit dhe faqeve e-commerce. Kërkimet, studimi, planifikimi, projektimi, konsultimi, asistencë teknike, promovimi dhe realizimi i të gjitha aktiviteteve që përfshijnë sektorin e T.I.K (Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit); promovimin e hulumtimeve dhe studimit të teknologjive të avancuara në fushën e energjisë, materialeve dhe TIK në aplikacione të ndryshme multi-disiplinore, shkencore, teknike dhe socio-ekonomike; përhapjen e njohurive ndërmjet



studiuesve, prodhuesve, perpunuesve dhe Perdoruesit fundor (end-user) te teknologjive te reja ne fushat e interesit te vete kompanise. Hulumtimi dhe eksperimentimi ne fushen e komunikimit, ne fushen e softëare dhe hardëare dhe ne teknologjite e reja, edhe ne lidhje me prodhimin e materialit 3D stereo. Botimet dhe informimet si ne forme te shkruar, multimediale apo me ane te internetit nepermjet publikimit, shperndarjes dhe reklamimit. Realizimi i siteve, faqeve, radiove, TV, WEBTV, IPTV, Mobile TV, gazetave, revistave, numrave te vetem apo suplementeve, guida, broshura, programe te transmetimit dhe peer to peer. Si dhe realizimin e studiove televizive radiofonike te reklamuar me ane te internetit, dixhitalit satelitor dhe tokesor. Prodhimin e produkteve me karakter informues dhe gazetaresk ne favor te konsumatoreve te trete. Duke perfshire dhe pergatitjen dhe prodhimin dhe post prodhimin te produkteve audiovisive kinematografike dhe televizive dhe realizimin e projektit, furnizimin, transferimin dhe promovimin e sherbimeve multimediale te bazuara ne dixhitalizimin tokesor. Krijimin dhe shperndarjen e imazheve dhe te grafikeve, fotografive, radiofonive, televizive multimediale dhe nepermjet instalimit fiks apo te levizshme te reklamave dhe te objekteve promovuese; Realizimin dhe menaxhimin e data base, softëare, botimeve, kartat e menaxhimit te sherbimit, konferenca, gazeta, mailings, telemarketing, sondazhi i opinionit, planifikimi dhe aktivizimi i komunitetit online, realizimi i projekteve te internetit, televizionit. Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejëpjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë object të ngjashëm apo të përafërt me të vetin. Gjithashtu, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji mund të lëshojë garanci, letra dëmshpërblimi dhe çdo garanci tjetër reale.

Ofrimi i sherbimeve te Konsulences per kompanite, entet publike, si dhe individet ne fushen financiare, strategjite industriale dhe ceshtjet e lidhura (duke perfshire operacionet e ristrukturimit dhe/ose te biznesit ose riorganizimin e shoqerive), si dhe sherbime keshilluese ne lidhje me bashkimet, joint venture, shkrirjet, kuotat, bashkimet, blerjete shoqerive, pjesemarrjet ne kapitalin e shoqerive, ne filale ose ne deget e shoqerive dhe transaksione te tjera te jashtezakonshme dhe transaksione financiare te korporatave, si dhe pergatitjen e studimeve dhe analizave te tregut, zhvillimi i planeve te biznesit, kerkimi dhe gjetja e partnereve strategjike, organizimi i takimeve dhe konferencave dhe cdo gje tjeter te nevojshme per kryerjen eketyre sherbimeve te konsulences; Blerja, mbajtja, menaxhimi dhe transferimi i investimeve te qfaredo lloji ne shoqeri dhe biznese, si shqiptare dhe te huaja, aktivitete te blerjes, nenshkrimi dhe shitja e instrumenteve financiare, duke perfshire ato te listuara apo te tregtuara ne tregjet e rregulluara ose jo te rregulluara, me perjashtim te kryerjes se sherbimeve te investimeve dhe aktiviteteve, te rezervuara me ligj per lejet specifike. Hulumtimi, planifikimi i reklamave, blerja dhe shitja e hapesires reklamuese, kontrolli dhe menaxhimi i buxheteve te investimeve ne fushen e reklamave, si dhe ofrimin e sherbimeve ne sektorin e reklamave lidhur me investimet ne te gjitha fushat e komunikimit, duke perfshire sponsorizimet dhe promovimet, edhe nepermjet rekrutimit te mandateve me ose pa perfaqesim, si ne Shqiperi ashtu edhe jashte vendit. Kompania mund te lidhe kontrata per shitjen e asetave dhe sherbimeve, te permendura me siper, po ashtu



mbulon edhe shkembimin e mallrave dhe sherbimeve. Perdorimi dhe shfrytezimi i markave tregtare ne pergjithesi, si dhe marrja e ekskluzivitetit, brenda dhe jashte vendit; Promovimi i shitjeve, duke perfshire dhenien e konsulences ne marketing dhe konsulence biznesi ne pergjithesi, ofrimin e sherbimeve kreative dhe grafike, realizimin e reklamimit dhe fushatave promocionale ne te gjitha format e tyre; ustrimi i veprimtarive te marredhenieve publike qe synon krijimin, rritjen dhe forcimin e imazhit te shoqerive kliente. Shoqëria në ustrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ustrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 2

Emri dhe selia e shoqerise

2.1 Shoqeria eshte person juridik shqiptar. Shoqëria fiton personalitet juridik në momentin e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar Shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

2.2 Shoqeria do te paraqitet ne qarkullimin tregtar me emërtimin e saj **Infolab**. Ndryshimi i emrit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

2.3 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën në Shqipëri, Tiranë, Njesia bashkiake nr 5, Rruga Donika Kastrioti, Pallati nr 14, Kati 1, Ap. 7, Zona kadastrale 8270

NENI 3

Kohëzgjatja e shoqerise

Shoqeria do te kete nje kohezgjatje te pacaktuar.


NENI 4

Regjimi Juridik i Shoqerise

4.1 Shoqeria udhehiqet nga parimet e ekonomise se tregut dhe ka per qellim fitimin. Ajo respekton parimin e reciprocitetit. Shoqeria tregtare Infolab eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (SHPK). Veprimtaria i nenshtrohet dispozitave te aktit te themelimit, statutit si dhe dispozitave te legjislacionit shqiptar tregtar e atij civil. Me vendim te Asamblese se Pergjithshme, shoqeria mundet qe te ndryshoje regjimin juridik te saj ne perputhje me dispozitat ligjore qe do te jene ne fuqi si dhe ne perputhje te plote me dispozitat e Aktit te themelimit dhe te statutit te saj, duke bere dhe pershtatjen e tyre sipas ndryshimeve perkatese.

4.2 Shoqeria gazon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin tregtar. Shoqeria do te kete vulen e saj.

II. TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKUT



NENI 5

Te drejatat dhe detyrimet e ortakeve

5.1 Ortaku mban pergjegjesi per humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara.

Pasurite e krijuara nga shoqeria gjate aktivitetit te saj jane ne pronesi te shoqerise. Ato (pasurite) mund te tjetersohen, te jepen me qera, me miratimin e Asamblese se Pergjithshme. Ne kete rast vendimmarrja duhet te jete unanime me 100% te kapitalit.

5.2 Ortaket japin kontributin e tyre ne shoqeri ne para apo ne natyre, sipas menyrave dhe afateve te percaktuara ne statut dhe ne marreveshjen e posacme te lidhur midis tyre, ne te cilen eshte percaktuar ne menyre te detajuar kontributi i secilit dhe menyra e afatet e derdhjes se ketij kontributi ne kete shoqeri. Ata pergjigjen ndaj shoqerise personalisht dhe ne menyre solidare per demet e shkaktuara nga mospermbushja e ketyre detyrimeve apo nga permbushja e tyre pertej afateve perkatese.

5.3 Personat pergjegjes per administrimin e shoqerise informojne te gjitha ortaket per ecurine e veprimtarise se shoqerise tregtare dhe me kerkesen e tyre , duhet t'u vene ne dispozicion llogarite vjetore, perfshire llogarite e konsoliduara, raportet per gjendjen dhe ecurine e veprimtarise se shoqerise tregtare, raportet e organeve drejtuese apo te eksperteve kontabel te autorizuar, si dhe cdo dokument tjeter tjeter te brendshem te shoqerise.

5.4 Personat pergjegjes per administrimin e shoqerise informojne ortaket per periudha nje mujore dhe tre mujore per ecurine e shoqerise, realizimin e objektive mujore dhe tremujore, llogarite, raportet per gjendjen dhe ecurine e veprimtarise se shoqerise tregtare me partneret nenkontraktore, raportet e organeve drejtuese apo te eksperteve kontabel te autorizuar, si dh e cdo dokument tjeter te brendshem te shoqerise.

5.5 Ortaket e shoqerise kane te drejte te heqin dore nga shoqeria dhe mund te shesin kuoten e tyre ne kapitalin shoqerise, ne perputhje me kushtet qe i lejon statuti dhe ligji. Heqja dore nga shoqeria nuk i liron ata nga detyrimet qe kane deri ne momentin e heqjes dore dhe nuk i cenon ata ne marrjen e te ardhurave qe shoqeria ka siguruar deri ne kete moment.

5.6 Gjate ushtrimit te te drejtave, ortaket veprojne, duke marre parasysh interesat e shoqerise dhe te ortakeve te tjere. Ata gezojne te njejtat te drejta kane te njejtat detyrime e trajtohen ne menyre te barabarte. Ortaket respektojne detyrimet qe burojne nga akti i themelimit dhe statuti. Ata perpiqen per zhvillimin normal te shoqerise sipas objektit te veprimtarise se saj.

NENI 6

Ndalimi i konkurences



6.1 Ortaket nuk mund te mbajne statusin e tregtarit per te ushtruar veprimtari ne kete sektor. Ndalimi i permendur me siper mund te shfuqizohet nepermjet nje autorizimi te posacem, te dhene nga ortaket, apo nga Asambleja e Pergjithshme me unanimitet te votave. Ky autorizim mbetet ne fuqi edhe pas humbjes se cilesive apo statusit te permendur ne te, por jo per nje periudhe me te gjate se nje vit pas humbjes se kesaj cilesie.

6.2 Nese ndonjeri prej ortakeve shkel ndalimin e konkurences, shoqeria mund:

- a) te perjashtoje ate nga shoqeria apo ta shkarkoje nga detyra;
 - b) te kerkoje nderprerjen e veprimtarise konkuruese;
- te ngreje padi per shperblimin e demit.

Shoqeria , si alternative te ngritjes se padise per shperblimin e demit, mund t'i kerkoje secilit prej ortakeve;

- a) te pranoje se transaksionet e kryera per llogari te tij te kalohen per llogari te shpoqerise;
- b) t'i transferoje shoqerise te gjitha perfitimet qe ka marre nga kryerja e veprimeve per llogari te personave te trete;
- c) t'i transferoje shoqerise te gjitha te drejtat e kredite, qe kane rrjedhur nga kryerja e veprimeve per llogari te personave te trete.

NENI 7


Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per cheshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
- dh) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqerisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;



i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 8

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 9

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.


NENI 10

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;



- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 11

Përfshirja nga e drejta e votës

11.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

11.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

III. KUSHTET EKONOMIKE TE SHOQERISE

NENI 12

12.1 Veprimtaria e funksionimit të shoqërisë bazohet në kërkesat e ekonomisë të tregut. Veprimtaria ekonomike ndërtohet mbi parimet e llogarise dhe pasqyrohet në bilancet e saj.

12.2 Kapitali i regjistruar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi në para i ortakëve në vlerën 100.000 (njëqind mijë) leke. Kuotat e kapitalit janë të ndara në 1 pjesë të barabarta me vlerë nominale **100.000 lekë sejcila** me kontributin e ortakut si më poshtë:

Emri Mbiemri	Përqindja	Kuota	Kontributi në
z. Bledar HITAJ	100%	1	100.000 lek

12.3 Ortaket, në bazë të kërkesës së organit administrues, mund të sjellin para në shoqëri, sipas marrëveshjes paraprake të lidhur midis tyre. Kjo derdhje parash mund të bëhet në formën e zmadhimit të kapitalit ashtu si dhe në formën e financimit të shoqërisë. Në rastin e financimit të shoqërisë nga ortaket në formë huaje, nuk është e

nevojshme te respektohet perpjesshmeria mes shumes se derdhur ne shoqeri dhe kuotave te kapitalit qe ortakët zoterojnë.

12.4 Nese mes paleve nuk ka akorde specifike, financimet ne forme huaje te bera nga ortakët do te konsiderohen si hua pa interes.

NENI 13

Pasuria e shoqerise

Shoqeria behet pronare e pasurise se luajtshme e te paluajtshme kur vlera e pasurise mbulohet teresisht ne te holla.

NENI 14

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i regjistruar i shoqerise mund te zmadhohet ose te zvogelohet nga Asambleja e Pergjithshme. Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Zmadhimi i kapitalit mund te vendoset kur e kerkojne interesat e shoqerise duke u vendosur rritja e vleres se kuotes se ortakeve.

Asambleja e Pergjithshme, vendos per zvogelimin e kapitalit te shoqerise. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkojnë për ndryshimin e statutit.

Zvogelimi i kapitalit nuk duhet te demtoje kreditorët e as te krijojë pasiguri tek ata qe kane dhene kredi para publikimit te zvogelimit te kapitalit. Ne te kunderten Gjykata e konsideron te pavlefshem kete vendim mbi kerkesen e kreditorëve.


Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

NENI 15

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;



d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme nga ortaku, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

NENI 16

Fondi rezerve

Shoqëria krijon fondin rezerve dhe fonde te tjera financimi per te perballuar nevojat e saj.

KREU III

ORGANET DREJTUESE

NENI 17

Administrimi

17.1 Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

17.2 Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

17.3 Personi i mëposhtëm caktohet Administrator i shoqërisë i cili do të ushtrojë dhe mbajë në mënyrë të veçantë kompetencat e administratorit, për një periudhë prej 5 (pese) vitesh.

Të dhënat e identifikimit:

dhe specimenët e nënshkrimit:

Bledar HITAJ

Adresa: Rruga Irfan Tomini, Njesia nr 5, Tirane

NENI 18

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;



- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë të detyruar të therasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 19


Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;



b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit


Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV

VITI FINANCIAR-EKSPERTET

NENI 20

Viti Financiar



Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

NENI 24

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

NENI 25

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Ky statut hartohet dhe firmoset në 5 (pesë) kopje origjinale, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore. Një kopje qëndron në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

ORTAKU

I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Infolab

Bledar HITAJ

